



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



QENDRA
MAQEDONASE PËR
EDUKIM
QYTETAR



Projekt për integrimin ndëretnik në arsim

RAPORT MUJOR

i Projektit të USAID-it për integrimin ndëretnik në arsim

janar 2017

I. AKTIVITETE TË ZBATUARA

Komponenti 1 - Informimi i opinionit dhe bashkësive

- **Trajnim për kënde kreative.** U mbajt trajnim treditor për kënde kreative në të cilin morën pjesë 10 mësime të pesë shkollave të mesme nga Maqedonia të cilët paraprakisht janë trajnuar dhe kanë zbatuar punëtori kreative dhe metodologjinë e forumit teatral. Qëllimi i trajnimit ishte në mënyrë shtesë të zhvillohen aftësitë dhe profesionalizmi i mësimeve që ata më tej të mund t'i bartin njohuritë e fituara të nxënësve në kuadër të shkollave të tyre. Mësimeve të cilët e ndanë trajnimin, gjatë shkurtit do të formojnë kënde kreative dhe do ta udhëheqin këtë proces kreativ me nxënësit e shkollave të mesme në shkollat e tyre.
- **Tryezë e rrumbullakët.** U mbajt tryezë e rrumbullakët me temë: “Roli dhe mbështetja e mediave në zhvillimin e kohezionit ndëretnik dhe integrimin në shkollë”, në të cilën morën pjesë tridhjetë përfaqësues të mediave, profesorë universitarë, ekspertë të institucioneve dhe përfaqësues të USAID-it. Qëllimi i tryezës së rrumbullakët ishte përmes diskutimit produktiv të zbatohen përvojat e deritanishme pozitive dhe praktikat në drejtim të përmirësimit të integrimin ndëretnik në shkollë, si dhe të diskutohen mënyrat potenciale për përfundimin dhe përmirësimin e rolit të mediave në këtë proces. Krahas diskutimit të hapur, fjalime të shkurtë patën edhe një përfaqësues i PINA, kryetari i grupit punës për arsim të integruar në MASH, si dhe një gazetar i kyçur në PINA.
- **Pjesëmarrje në emisione.** Përfaqësues të ekipit të PINA, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe një gazetar morën pjesë në programin e parë të Radios së Maqedonisë, me ç'rast në opinion u ndanë arritjet kyçe të projektit, rezultatet pozitive nga bashkëpunimi me institucionet arsimore kyçe si dhe roli i mediave në procesin e përfundimit të kohezionit ndëretnik.
- **Informim i rregullt i institucioneve, komunave dhe shkollave për aktivitetet e PINA.** Një pjesë e aktivitetëve kanë përfshirë edhe azhurnimin e rregullt të informacioneve dhe publikimin e risive dhe tregimeve për rrjedhën e aktivitetëve në faqen e facebook-ut *Integratika*, si dhe në ueb faqen e projektit www.pmio.mk.
Gjithashtu, aktivitetet të cilat u zhvilluan në kuadër të shkollave (të pavarura apo në partneritet me shkollat e tjera), gjatë asaj periudhe kishin mbështetje dhe mbulim medial.

Komponenti 2 – Ndërtimi i kapaciteteve të drejtorive të shkollave dhe arsimtarëve

- **Realizimi i Punëtorisë për anëtarët e Komisionit për vlerësimin e aplikacioneve në kuadër të programit për grante shkollore në kuadër të MASH.** U realizua punëtori njëditorë për anëtarët e Komisionit për vlerësimin e aplikacioneve të arritura në thirrjen publike të MASH për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e aktivitetëve të përbashkëta të nxënësve. Qëllimi i punëtorisë ishte anëtarët e Komisionit në mënyrë të detajuar të njoftohen me kriteret për përzgjedhjen e aplikacioneve se si t'u jepet mbështetja e nevojshme për vlerësimin e aplikacioneve.
- **Punëtori për përfundimin e rolit të komunës në ndryshimet për INA.** U mbajtën dy punëtori njëditorë me përfaqësuesit e komunave dhe shkollave të përfshira në bashkëpunimin e thelluar. Qëllimi i punëtorive ishte të këmbehen përvojat me sukseset dhe sfidat në aktivitetet

Projekt për integrimin ndëretnik në arsim

për INA, si dhe të propozohen dokumentet kryesore të cilat do të jenë në dobi të komunave dhe shkollave për realizimin e qëndrueshëm të aktiviteteve të INA.

- **Analizë e të dhënave të vlerësimit të pjesëmarrësve në aktivitetet me pjesëmarrjen e prindërve në INA.** Në zbatimin e programit grant për pjesëmarrjen e prindërve në aktivitetet për INA në nëntë shkolla fillore, janë përfshirë gjithsej 1115 pjesëmarrës (246 prindër, 117 mësimdhënës dhe 752 nxënës). Analiza e të dhënave të vlerësimit të prindërve dhe mësimdhënësve i tregoi qëndrimet e pjesëmarrësve lidhur me dobinë dhe përfitimet e aktiviteteve, si dhe rekomandimet e tyre për përforsimin e pjesëmarrjes së prindërve në aktivitetet për INA.
- **Përpunimi i rezultateve të pyetësorit për nxënësit-pjesëmarrës të aktiviteteve “Ditët e integritetit ndëretnik”.** Është bërë përpunimi statistikor i të dhënave të pyetësorit i cili është zbatuar me qëllim që të maten efektet tek nxënësit e bashkësive të ndryshme etnike të cilët morën pjesë në aktivitete të përbashkëta në kuadër të aktivitetit të projektit Ditët për INA.

Komponenti 3 – Shkolla modele

- **Aktivitet profesional.** Në shkollën fillore modele “Bratstvo Edinstvo”, Ohër, përmes aktiveve profesionale, është miratuar strategji për mbajtjen e orëve të përbashkëta/të integruara për të gjithë mësimdhënësit (dhe mësimin klasor dhe të lëndëve). Është paraparë çdo mësimdhënës të mbajë të paktën nga dy orë të përbashkëta.
- **Trajnime.** Gjatë muajit përfaqësues të shkollës fillore modele “Bratstvo Edinstvo”, Ohër morën pjesë në punëtorinë për përforsimin e rolit të komunës në ndryshimet për INA, me ç’rast është theksuar roli i shkollave modele në organizimin e aktiviteteve promovuese dhe rolin e komunave për mirëmbajtjen e aktiviteteve INA.

Komponenti 4 - Nxitja e shkollave

- **Aktivitete për rinovim.** Në vijim janë aktivitetet të cilat janë obligim i PINA në shkollën fillore muzikore komunale “Lazo Micev Rale”, komuna e Kavadarit.
- **Certifikata për pjesëmarrje në trajnime.** Janë përgatitur certifikata për pjesëmarrje në trajnimet për mirëmbajtjen e objekteve shkollore për anëtarët e SRT, sekretarët e shkollave dhe personelin teknik prej 63 shkollave të rinovuara. Numri i përgjithshëm i certifikatave të shtypura, gjegjësisht i personave të cilët do të marrin certifikatë është 623.
- **Takime mujore në 15 shkolla të fazës 5 për ndjekjen e punës për mirëmbajtjen e objekteve shkollore.** Të gjitha 15 shkollat e rinovuara në fazën 5 janë kontaktuar nga persona profesionistë të cilët e kanë ndjekur punën dhe procedurat e mirëmbajtjes së shkollave, me ç’rast u është ofruar ndihmë profesionale e mirëmbajtjes së objekteve shkollore.

Monitorimi dhe vlerësimi

- **Aktivitete për monitorim dhe vlerësim.** Monitorimi i aktiviteteve vijuese të PINA. Përpunimi i të dhënave nga vlerësimi i aktiviteteve të realizuara për Ditët për INA. U punua edhe në përgatitjen e raportit final për monitorim dhe vlerësim.

Projekt për integrimin ndëretnik në arsim

II. AKTIVITET VIJUESE PËR MUAJIN E ARDHSHËM

Komponenti 1 – Informimi i opinionit dhe bashkësive

- Organizimi dhe mbajtja e konferencës debatuuese: Integrated Talks.
- Edicioni i dytë i Festivalit „Bëhu kreativ – Bëhu interaktiv – Bëhu interetnik”.
- Mbajtja e punëtorive në kuadër të këndeve kreative me nxënës dhe mësimsdhënës.
- Ngjarje promovuese për promovimin e publikimeve të PINA.
- Azhurnim i rregullt i informacioneve dhe publikimi i risive dhe rrëfimeve gjatë aktiviteteve përmes faqes së Facebook-ut Integratika dhe ueb – faqes së projektit www.pmio.mk.

Komponenti 2 – Ndërtimi i kapaciteteve të drejtorive të shkollave dhe arsimtarëve

- Vazhdimi me punëtoritë për përforcimin e rolit të komunës në ndryshimet për INA.
- Kamp dimëror me pjesëmarrësit dhe mësimsdhënësit prej pesë shkollave fillore.
- Trajnim për studentët e fakulteteve pedagogjike.
- Ngjarje për promovimin e publikimeve më të reja të PINA.

Komponenti 3 – Shkolla modele

- Takime të punës me përfaqësuesit e komunave dhe përfaqësuesit e SIT të shkollave modele.
- Mbajtja e prezantimeve shkollore për ndryshime dhe efekte nga aktivitetet INA në dy Shkolla modele.
- Shfaqje me rastin e patronatit të SHF “Sande Shterjoski”, Kërçovë.

Komponenti 4 - Nxitja e shkollave

- Aktivitetet për rinovim dhe kontroll teknik të objektit të rinovuar shkollor në SHFKM “Lazo Micev Rale”, komuna e Kavadarit pas përfundimit të aktiviteteve ndërtimore.
- Takim i grupit punues të komponentit 4.
- Takime mujore në 15 shkolla të fazës 5 për ndjekjen e punës për mirëmbajtjen e objekteve shkollore.
- Përgatitja e konferencës për prezantimin e praktikave të mira për mirëmbajtjen e shkollave për personel teknik të 63 shkollave të rinovuara.

Monitorimi dhe vlerësimi

- Finalizimi i raportit final për Monitorim dhe vlerësim.
- Aktivitete për grupin punues për INA në kuadër të MASH.